REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 qershor 2018
Nr. ref.: RK 1268/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI40/18

Parashtrues

Hysen Idrizi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 271/2017, të 11 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysen Idrizi nga fshati Sllatinë e Madhe, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Supreme), Rev. nr. 271/2017, të 11 janarit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), CA. nr. 1505/2015, të 5 korrikut 2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), Cl. nr. 103/2004, të 30 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) dhe 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), nenin 23 (1) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe nenet 1, 2, 3 dhe 4 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 mars 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 23 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 27 mars 2018, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 28 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 korrik 1991, parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës në Ndërmarrjen Publike "Elektroekonomia e Kosovës" (në tekstin e mëtejmë: N. P. "Elektroekonomia"), përmes Aktvendimit nr. 4369.

10. Në një datë të pasaktësuar në vitin 1991, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozim në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Punës së Bashkuar), për anulimin e Aktvendimit nr. 4369 të N. P. "Elektroekonomia".

11. Në një datë të pasaktësuar në vitin 1999, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) që t'i lejohet ripërtëritja e rastit pasi shkresat e lëndës kishin humbur për shkak të *"luftës së vitit 1999 në Kosovë"*.

12. Më 4 mars 2004, Gjykata Komunale me një aktvendim (me numër të pasaktësuar), të 29 marsit 2004, kishte lejuar ripërtëritjen e shkresave të lëndës së parashtruesit.

13. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte ndryshuar padinë, duke paditur tani Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), që sipas parashtruesit ishte trashëgimtare juridike e N. P. "Elektroekonomia".

14. Më 10 dhjetor 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit Cl. nr. 103/2004, refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për kompensimin e pagave për periudhën prej 20 korrikut 1991 deri më 15 korrik 1999, si të pabazuar, pasi konstatoi se KEK nuk kishte legjitimitet pasiv në lidhje me padinë e parashtruesit për kompensimin e pagave për periudhën e cekur më lart, pasi nuk ishte trashëgimtare e N. P. "Elektroekonomia". Gjykata Themelore konstatoi se KEK ishte regjistruar si subjekt afarist i veçantë më 6 tetor 2000, me numër regjistrimi 80248059 të lëshuar nga UNMIK-u.

15. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (Cl. nr. 103/2004), parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar *"shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të së drejtës materiale"*. KEK kishte paraqitur përgjigje në ankesën e parashtruesit.

16. Më 5 korrik 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit CA. nr. 1505/2015, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (Cl. nr. 103/2004), duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës *"nuk dëshmoi legjitimitetin real pasiv"* të KEK-ut në këtë çështje juridike.

17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 1505/2015), parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, ku pretendoi *"shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale"*.

18. Më 11 janar 2018, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 271/2017, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 1505/2015). Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi:

> *"Dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit nuk përfshihet me paqartësi dhe kundërthënie,*

përkundrazi diapozitivi është i qartë, në të përshkruhen qartë kërkesat e paditësit [parashtruesit të kërkesës] të cilat janë refuzuar, ndërsa në arsyetimin e tyre janë dhënë arsye të qarta dhe bindëse lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për vendimmarrje të drejtë të kësaj çështjeje juridike.
[...]

[KEK] nuk ka legjitimitet lëndor në rastin konkret, ajo nuk e ka larguar nga puna [Parashtruesin], atë e ka larguar një subjekt tjetër juridik. Pala ka legjitimitet lëndor vetëm nëse është pjesëmarrëse e marrëdhënies materialo-juridike nga e cila ka lindur kontesti, andaj në rastin konkret e paditura nuk është palë e marrëdhënies materialo juridike, pra nuk ka legjitimitet real pasiv. Qëndron fakti se tani e paditura shfrytëzon asetet e ish-subjektit ekonomik i cili e ka larguar [parashtruesin e kërkesës] nga puna, mirëpo [...] nuk i detyrohet për veprimet e kundërligjshme të ish-subjektit ekonomik [...], andaj edhe kërkesëpadia e paditësit që të obligohet tani e paditura që t'ia paguajë të ardhurat e humbura personale prej vitit 1991 gjer në vitin 1999, [...] është e pabazuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 271/2017) ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, nenet 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) dhe 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, nenin 23 (1) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe nenet 1, 2, 3 dhe 4 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

20. Parashtruesi pohon se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara, pasi ato *"nuk përmbajnë një përmbledhje të thukët të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit gjyqësor [...], dhe një deklarim kuptimplotë të bazës ligjore në të cilin bazohen".*

21. Parashtruesi specifikon po ashtu se *"Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar, si gjykatë e shkallës se parë, me vendimin MP. nr. 4165/91 datë 20.11.1991, aprovon propozimin e [tij], ndërsa anulon si të kundërligjshëm aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës, MP. nr. 4369 datë 20.08.1991".* Sipas parashtruesit, vendimi i mësipërm nuk kishte marrë formën e prerë për shkak të *"ndodhisë së luftës"*. Në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se duke rikthyer rastin sërish në Gjykatën Themelore në instancë të parë dhe duke nxjerrë vendim kontradiktor me atë të Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar, Gjykata Themelore kishte bërë shkelje esenciale të procedurës kontestimore.

22. Në lidhje me statusin juridik të KEK-ut, parashtruesi pretendon se ajo është *"trashëgimtare [...] juridike e pakontestuar e Elektroekonomisë së Kosovës"* dhe ka legjitimitet të plotë pasiv që të jetë palë në procedurën në lidhje me rastin e tij. Kjo, sipas parashtruesit, dëshmohet me faktin se ai pas *"përfundimit të luftës"* ishte rikthyer përsëri në punë në KEK pa konkurs, duke u bazuar në vazhdimësinë e marrëdhënies së punës nga statusi i punësimit të mëhershëm.

23. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se ai ishte larguar nga puna në vitin 1991 në mënyrë diskriminuese. Në lidhje me këtë, ai gjithashtu ngrit pyetjen se si mund *"të shpjegohet rrjedha procedurale civile absolutisht analoge dhe me bazë të njëjtë juridike dhe periudhë të njëjtë kohore (1990-1999) e punonjësve të Fabrikës së Çelikut "IMK" në Ferizaj [...] e cila qenka trashëgimtare e drejtpërdrejt dhe pasuese juridike e pakontestuar e IMK Çeliku"*, duke paraqitur si provë Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010, në rastin KI08/09.

24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall kërkesën të pranueshme dhe të bazuar.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

28. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën si individ dhe si palë e autorizuar, kërkesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

29. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

30. Gjykata po ashtu i referohet paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 271/2017), duke hedhur poshtë si të pabazuar revizionin e paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 1505/2015), i ka shkelur atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën kundër diskriminimit, të drejtën për punë dhe të drejtën për mjete efektive juridike.

32. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Gjykatës së Apelit për arsye procedurale dhe nuk ishte marrë me përmbajtjen e padisë, pasi KEK nuk kishte legjitimitet pasiv në lidhje me padinë e parashtruesit për largimin e paligjshëm nga puna në N. P. "Elektroekonomia" nga viti 1991 deri në vitin 1999.

33. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).

34. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, para. 65, shih po ashtu, *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

35. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte vlerësuar interpretimin e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit sa i përket dispozitave procedurale në lidhje me legjitimitetin pasiv të KEK-ut.

36. Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk i kishin arsyetuar vendimet e tyre sa i përket pretendimeve të parashtruesit, konstatoi se "*dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk përfshihet në paqartësi dhe kundërthënie. Përkundrazi dispozitivi është i qartë, në të përshkruhen qartë kërkesat e parashtruesit të kërkesës të cilat janë refuzuar, ndërsa në arsyetimin e tyre janë dhënë arsye të qarta dhe bindëse lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për vendimmarrje të drejtë të kësaj çështjeje juridike*".

37. Në lidhje me legjitimitetin pasiv të KEK-ut në procedurën e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme arsyetoi se "*KEK nuk ka legjitimitet lëndor në rastin konkret, sepse ajo nuk e ka larguar nga puna paditësin dhe rrjedhimisht nuk është pjesëmarrëse e marrëdhënies materialo-juridike nga e cila ka lindur kontesti*". Ndërsa Gjykata e Apelit kishte arsyetuar se KEK ishte regjistruar nga UNMIK-u si ndërmarrje e re në vitin 2000 dhe si e tillë, nuk është trashëgimtare juridike e N. P. "Elektroekonomia".

38. Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesit i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i konsideron të rëndësishme për rastin e tij.

39. Gjykata vëren se të gjitha argumentet e parashtruesit, të cilat ishin relevante për vendosjen në lidhje me legjitimitetin pasiv të KEK-ut në rastin konkret, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar nga gjykatat. Ashtu sikundër që gjykatat e rregullta dhanë të gjitha arsyet materiale dhe ligjore që lidhen me vendimin e kontestuar. Si rrjedhojë, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).

40. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

41. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33).

42. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*, përkatësisht nuk e ka mbështetur pretendimin që tregon se ai ishte i diskriminuar në procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës. Ashtu sikundër që ai nuk ka argumentuar se si rasti i tij ishte i ngjashëm me rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI08/09, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010.

43. Gjithashtu, Gjykata vëren se, përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës për punë dhe të drejtës për mjete efektive juridike, parashtruesi i kërkesës përveç referencave në nene specifike të konventave ndërkombëtare nuk ka paraqitur argumente se si dhe pse gjykatat e rregullta i kishin shkelur atij këto të drejta.

44. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk

është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).

45. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me Kushtetutë.

46. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 28 maj 2018, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi